



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No:	05-9909
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 5 -
Data: Datum: Date:	18 / 12 / 20 24
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva


PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

EMRI I PSO: AKTIVIZIMI DHE DEKTIVIZIMI I QOESH

PËRMBAJTJA: PROCESI DHE PROCEDURAT PËR AKTIVIZIMIN DHE DEAKTIVIZIMIN E QENDRAVE OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT 17.12.2024
AUTOR: MSh
NR. I HAPAVE: IV
NR. I NËNHAPAVE: 29

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh


v.v



QËLLIMI	QËLLIMI I PSO-SË ËSHTË OFRIMI I UDHËZIMEVE PËR AKTIVIZIMIN DHE DEAKTIVIZIMIN E QOESH-P-SË
NDËRLIDHJA ME AKTET	LIGJI NR.08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E LIGJT PËR SËMUNDJE NGJITËSE PLANI I VEPRIMIT PËR QENDRAT OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK
LISTA E SHKURTESAVE	MSH- MINISTRIA E SHËNDETËSISË IKSHPK- INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK TË KOSOVËS QOESH-P – QENDRA OPERATIVE EMERGJENTE TË SHËNDETIT PUBLIK RRNSH-RREGULLORJA NDËRKOMBËTARE E SHËNDETIT

PROCEDURA

Nr	HAPI	NËN-HAPAT
I	Monitorimi i rregullt i rasteve/ngjarjeve me shqetësim për shëndetin publik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kur raportohet dhe konfirmohet një incident me shqetësim për shëndetin publik që kërkon reagim emergjent shëndetësor, IKSHPK cakton menaxherin e QOEShP, i cili e njofton MSh-në për aktivizimin e QOEShP; 2. Kriteret për aktivizim janë kur: <ol style="list-style-type: none"> a. ka një emergjencë me potencial të mbingarkesës së madhe të shëndetit publik; b. një epidemi e shqetësimit kombëtar (që prek disa rajone) që shoqërohet me raste të shumta të personave të sëmurë/vdekur; c. incidenti mbingarkon burimet në dispozicion, përkatësisht kur personeli i rregullt i institucioneve shëndetësore është i mbingarkuar dhe kërkohet mbështetje shtesë ; d. çdo rrethanë që ka përmbushur kriteret për t'u shpallur emergjencë e shëndet publik e interesimit ndërkombëtar (eshpin), në përputhje me rrnsh 2005; e. gjendje me ndikim potencial me vendet fqinje.
II	Aktivizimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxheri i QOESH P thërret Ekipin për menaxhimin e incidentit sipas listës së thirrjes dhe natyrës së incidentit; 2. Caktohen detyrat e secilit anëtar të Ekipit për menaxhimin e incidentit; 3. Sigurohet që të gjithë anëtarët e kanë kuptuar qartë rolin dhe përgjegjësitë e tyre brenda ekipit. 4. Aktivizohet infrastruktura operative si burimet teknologjike dhe logjistika (telefoni, IT, dokumentacioni i duhur dhe pajisjet e nevojshme teknike dhe teknologjike) për funksionimin e QOESH P; 5. Caktohen oraret për mbledhje të rregullta për të vlerësuar progresin, për të bërë përditësime dhe diskutuar çështjet emergjente që kërkojnë veprime të shpejta; 6. Ekipi për menaxhimin e incidentit kujdeset për grumbullim, analizimin (lloji i incidentit, shtrirja e tij, ndikmi në komunitet dhe burimi i infeksionit) dhe shpërndarjen e informacionit.

III	Koordinimi i reagimit nga Menaxheri i Incidentit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosjen e kanaleve të komunikimit midis Ekipit menaxhues dhe partnerëve kryesorë, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë - Qendrën Operative të saj, institucionet shëndetësore, dhe organizatat ndërkombëtare nëse është e nevojshme; 2. Koordinimin e aktiviteteve të mbështetjes së reagimit të ekipeve në terren; 3. Përditësimin e vazhdueshëm lidhur me aktivitetet e reagimit; 4. Njoftimin e vazhdueshëm të Departamentit të Epidemiologjisë/IKSHPK, MSh dhe institucioneve të tjera lidhur me ecurinë e ngjarjes apo emergjencës së shëndetit publik; 5. Ndarjen e informacioneve të nevojshme për publikun dhe palët e tjera përmes Zyrave të komunikimit të MSH dhe IKSHPK dhe kanaleve zyrtare të komunikimit; 6. Siguron që informacioni i ndarë të jetë i qasshëm, i qartë, i saktë, i koordinuar dhe në përputhje me udhëzimet zyrtare; 7. Vendoset një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të situatës dhe të dhënat përditësohen në vazhdimësi.
IV	Deaktivizimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kur MSh dhe IKSHPK vlerësojnë në bazë të treguesve se emergjenca është nën kontroll ose ka përfunduar, QOESHP çaktivizohet dhe kthehet në gjendjen e zakonshme të funksionimit; <p>Menaxheri i Incidentit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Njofton institucionet përkatëse lidhur me deaktivizimin e QOESHP; 3. Harton dhe shpërndan planin e deaktivizimit; 4. Monitoron procesin e dektivizimit; 5. Siguron që formularët, raportet dhe dokumentet e secilit sektor/njësi të jenë përfunduar dhe dorëzuar tek njësia e dokumentimit ose zyrtari përgjegjës; 6. Rekomandon kohën dhe hapat e demobilizimit të të gjitha resurseve të përdorura në reagim; 7. Palos dhe ripaketon hartat, grafiket, materialet e ri përdorshme; 8. Mbledh gjërat që janë dislokuar në terren për përdorim në të ardhmen;

		<p>9. Bën listën e furnizimeve që duhet të zëvendësohen dhe e përcjell tek zyrtari përgjegjës për logjistikë;</p> <p>10. Harton raportin për deaktivizimin;</p> <p>11. Sigurohet që çështjet e mbetura që duhet adresuar nga institucioni janë përfunduar ose do të adresohen pas dektivizimit;</p> <p>12. Përgatitet për takimin e rishikimit pas veprimit;</p> <p>13. Inicion aktivitetet e vlerësimit të reagimit;</p> <p>14. Pas deaktivizimit, përgatitet një raporti përmbledhës për performancën dhe përmirësimet e mundshme të procesit për situatat e ardhshme.</p>
--	--	--